



A.nr.15/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.15/2026 të datës 09.01.2026, të parashtruar nga ankuesi SH.K, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprobuhet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.15/2026, e datës 09.01.2026, e parashtruar nga ankuesi SH.K.
- II. Anulohet** Vendimi Nr.Ref.02277/25 i datës 17.12.2025, i Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, si dhe Vendimi Ref.nr.02328/25 i datës 23.12.2025, i Drejtoreshës së Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.
- III. Obligohet** Drejtoresha e Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ta kthejë ankuesin në vendin e tij të punës sipas Akt emërimit me Nr.00113/2025 të datës 06.01.2025, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.
- IV. Obligohet** Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke larguar nga dosja personale masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, SH.K (në tekstin e mëtejshme referuar: ankuesi), më datë 09.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Ref.02277/25 të datës 17.12.2025, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, me datë 19.01.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, ndërsa kjo e fundit më datë 04.02.2026, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, përmes Vendimit VK/2026 dhe numër protokolli 890/2026, të datës 20.02.2026, ka shtyrë afatin për vendorsje të ankesës me numër A.nr.15/2026 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4441/2025 të datës 09.01.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Deklaratën e ankuesit të datës 10.12.2025; Vendimin me Ref.nr.02328/25 të datës 23.12.2025; Vendimin Nr.Ref.02277/25 të datës 17.12.2025; Komentet lidhur me procedurë disiplinore; Akt emërimit me Nr.00134/2025 të datës 06.01.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.01.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 04.02.2026; E-mailin e datës 05.12.2025; E-mailin e datës 01.12.2025; E-mailin e datës 10.12.2025; E-mailin e datës 10.12.2025; Procesverbalin e datës 20.11.2025; Procesverbalet e datës 02.12.2025; Procesverbalin e datës 11.12.2025; E-mailin e datës 05.12.2025; E-mailin e datës 11.03.2026; Vendimin Ref.nr.01461/25 të datës 30.07.2025; Vendimin Ref.nr.01463/25 të datës 30.07.2025; Kontratën me Nr.01/2024 të datës 05.12.2024; Diplomën me Nr.162/12 të datës 24.05.2012; Diplomën me Nr.3347 të datës 21.07.2025; Diplomën me Nr.314/14 të datës 23.12.2014; Diplomën me Nr.1860 të datës 25.09.2018; E-mailin e datës 24.10.2025; Vendimin Ref:02091/25 të datës 14.11.2025; Vendimin A.nr.1259/2025 të datës 03.09.2025, me provat e administruara.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës konstaton se ankuesi, sipas Akt emërimit me Nr.00113/2025 të datës 06.01.2025, është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar mbështetës* pranë Divizionit të IT-së-Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme, në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Tutje nga shkresat e lëndës, rrjedh se Ushtuesi i Detyrës së Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji Informative në Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, në cilësi të mbikëqyrësit së drejtpërdrejt të ankuesit, përkatësisht duke u bazuar në dispozitat e nenit 55 paragrafit 1, nenit 59 paragrafit 1, 2 dhe paragrafit 3 nën paragrafit 3.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me datë 05.05.2025 ka parashtruar kërkesën me Nr.Ref.00907/25 për inicimin e procedurës disiplinore ndaj këtij të fundit, tek Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit, me supozimin për shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe rregullave të përcaktuara me kodin e etikës, sjelljes së papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil, dëmtimit të pasurisë shtetërore, përdorimit të saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimit të pasurisë shtetërore, të përcaktuara nga neni 56 paragrafi 4 nën paragrafët 4.6, 4.7 dhe 4.13 të këtij ligji, gjegjësisht lidhur me pretendimet për formatizimin e kompjuterit të vet ankuesit, ndërrimit të pajisjeve kompjuterike pa autorizim apo aprovim paraprak si dhe me refuzimin e tij për të dorëzuar pajisjen zyrtare. Ndër të tjera, ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor, pezullimin e përkohshëm të ankuesit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, bazuar në nenin 59 paragrafin 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me datë 05.05.2025 ka nxjerrë Vendimin Nr.Ref:00925/25, përmes të cilit akt ka pezulluar përkohësisht nga puna ankuesin.

Ndërsa, me datë 17.06.2025, Komisioni Disiplinor ka nxjerrë Vendimin Nr. Ref: 01209/25, përmes të cilit akt ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara nga neni 56 paragrafin 4 nën paragrafin 4.7 dhe 4.13 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht për sjellje të papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil dhe dëmtimit të pasurisë shtetërore, përdorimit të saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore, si rrjedhojë i ka shqiptuar masën disiplinore “*transferim në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë*”, sipas nenit 57 paragrafi 2 nën paragrafit 2.3 të këtij ligji, kurse lidhur me shkeljen e kodit të etikës ka konstatuar se e njëjta është e pabazuar.

Më tej, Drejtoresha e Sekretarisë Ekzekutive e Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, me datë 24.06.2025 ka nxjerrë Vendimin Ref.nr.01253/25, për zbatimin e Vendimit Nr.Ref: 01209/25 ë datës 17.06.2025, të Komisionit Disiplinor, ashtu që përmes këtij akti ka caktuar ankuesin në pozitën e punës “Zyrtar Regjional i Pranimi” në Departamentin për Koordinim Regjional, pranë Zyrës Regjionale në Mitrovicë, dhe atë nga data 24.06.2025.

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.Ref:01209/25 të datës 17.06.2025 si dhe Vendimit Ref.nr.01253/25 të datës 24.06.2025, me pretendimin ankimor se Komisioni Disiplinor ka nxjerrë vendimin përkatës pa ofruar prova apo dëshmi se i njëjti ka kryer shkelje disiplinore dhe se i njëjti nuk ka marrë për bazë argumentet e tij, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil. Andaj, ankuesi kërkon aprovimin e ankesës, anulimin e akteve kontestuese me obligimin që Drejtoresha e Sekretarisë Ekzekutive, ta kthejë të njëjtin në vendin e tij të punës Zyrtar mbështetës në Divizionin e IT-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit A.nr.1259/2025 të datës 03.09.2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit, ka shfuqizuar Vendimin Nr.Ref:01209/25 të datës 17.06.2025 të Komisioni Disiplinor të Agjencisë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, si dhe Vendimin Ref.nr.01253/25 të datës 24.06.2025 të Drejtoreshës së Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, ashtu që ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor.

Me rastin e kthimit në rishqyrtim dhe rivendosjes tek Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, së lëndës përkatëse, Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kishte detyruar këtë të fundit në ri procedurë të veproj sipas pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, dhe ashtu që duke marrë parasysh se ankuesi pretendon se hardisku i vjetër është lënë në zyrë, të ftoj për deklarime edhe kolegët e zyrës- Divizionit të TI-së, sikurse edhe ankuesin, ndërsa me qëllim të konstatimit se a është dëmtuar hardisku dhe se a duhej të ndërrohej i njëjti, duke marrë për bazë dispozitat e Rregullores MF-NR.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizata Buxhetore si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.21/2009 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare të ftoj ekspert nga fusha e TI-së për vlerësim profesional të rastit përkatës, dhe pas konstatimit në mënyrë të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të nxjerr vendim meritore në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, me datë 17.12.2025 ka nxjerrë Vendimin Nr.ref.:02277/25, përmes të cilit akt ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara nga neni 56 paragrafin 4 nën paragrafin 4.7 dhe 4.13 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht për sjellje të papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil dhe dëmtimit të pasurisë shtetërore, si rrjedhojë i ka shqiptuar masën disiplinore “*transferim në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë*”, sipas nenit 57 paragrafi 2 nën paragrafit 2.3 të këtij ligji.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.ref.:02277/25 të datës 17.12.2025, të Komisioni Disiplinor të Agjencisë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, ka parashtruar ankesë në Këshilli e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të moszbatimit real të Vendimit të KPMSHCK-së A.nr.1259/2025, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, keqinterpretimit dhe zbatimit të gabuar të nenit 56 paragrafit 4 nën paragrafit 4.7 dhe 4.13 të Ligjit Nr.05/L-197, shkeljes së rëndë së parimit të proporcionalitetit. Andaj, ankuesi propozon shfuqizimin e vendimit kontestues, anulimin e masës disiplinore si të paligjshme dhe jo proporcionale, apo alternativisht të kthejë lëndën në rishqyrtim, me detyrim për përfshirje të ekspertit të IT-së, vlerësimit profesional teknik të pajisjes, dhe respektimit të plotë të Vendimit A.nr.1259/2025 të KPMSHCK.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi që nga data e pezullimit nga marrëdhënia e punës e tutje, nuk ka pasur qasje në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit, faktikisht ankuesit masa disiplinore *transferim në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë*, e shqiptuar sipas Vendimit Nr. Ref: 01209/25 të datës 17.06.2025 të Komisionit Disiplinor, i ishte ekzekutuar sipas Vendimit Ref.nr.01253/25 të datës 24.06.2025 të Drejtoreshës së Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, e cila përmes këtij akti e në zbatim të vendimit të komisionit disiplinor e ka caktuar ankuesin në pozitën e punës “Zyrtar Regjional i Pranimi” në Departamentin për Koordinim Regjional, pranë Zyrës Regjionale në Mitrovicë, dhe atë nga data 24.06.2025, nga rrjedhë së në rastin

përkatës nuk janë marrë për bazë pikëpamjet juridike të arsytimit të organit epror, ngase me rastin e shfuqizimit të këtij vendimi për caktimin e ankuesit në këtë pozitë dhe vend pune, sipas Vendimit A.nr.1259/2025 të datës 03.09.2025, organi i punësimit detyrimisht duhej ta kthente ankuesin në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit, ndërsa, në këtë rast Agjencia përsëri edhe pas konstatimeve të theksuara në vendimin paraprak, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërlidhur me nenin 144 paragraf 1 të të njëjtit ligj ku është përcaktuar në mënyrë taksative se kur një akt administrativ bëhet i ekzekutueshëm, respektivisht është përcaktuar se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës”*. ngase në rrethanat e rastit konkret nuk është plotësuar asnjëri nga parakushtet ligjore që vendimi i kundërshtuar me ankesë të ekzekutohet, e për rrjedhojë ky veprim bie ndesh me dispozitat e nenit 2, nenit 8 paragrafi 2 dhe nenit 9 paragrafi 2 lidhur me pritshmëritë e ligjshme të palëve në procedurë dhe parimin e administratës së hapur sikurse përcaktohet me dispozitat e LPPA-së, rrethanë kjo e cila ka ndikuar që ankuesi të jetë në situatë jo të barabartë si palë në procedurë, respektivisht fakti që ankuesit menjëherë i është konfirmuar masa disiplinore, dhe është larguar nga vendi i tij i punës, duke u transferuar në një qytet apo regjion tjetër janë veprime që e kanë rënduar situatën në dëm të ankuesit, si në anën financiare apo edhe profesionale.

Me veprimet si më lartë janë krijuar pengesa që të zhvillohet procedura disiplinore në mënyrë të mirëfilltë nga Komisioni Disiplinor, ngase si rezultat i këtyre veprimeve të lartë theksuara të vet organit të punësimit ka ndikuar edhe në mos zbatimin e pikëpamjeve të Vendimit A.nr.1259/2025, për arsye se ankuesi pretendon se, citoj: *“Me datë 02.12.2025, -ora 10:30, ftohem të marrë pjesë në një tjetër seancë dëgjimore në lidhje me rastin e iniciuar për gjetjen e Hardiskut, ku Kryesuesi kërkon të shkojmë në zyrë për ta kërkuar atë hardisk, me të hyrë në zyrë aty mungojshin Tavolina, Fiokat, Kompjuteri, Monitorat dhe karrika me të cilat kam qenë i ngarkuar, e po në atë fiok në të cilin e kam letë atë disk nuk ishte fioka prezentë me ne zyrë”*, ndërsa, Komisioni Disiplinor në anën tjetër thekson se, citoj: *“Pasi që nuk është gjetur hardisku i kërkuar Komisioni nuk munda të zbatojë pjesën e vendimit të KPMSHCK-së, në të cilin kërkohet: “me qëllim të konstatimit se a është dëmtuar hardisku dhe se a duhej të ndërrohej i njëjti, duke marrë për bazë dispozitat e Rregullores MF-NR.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizata Buxhetore si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.21/2009 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare të ftoj ekspert nga fusha e TI-së për vlerësim profesional të rastit përkatës, dhe pas konstatimit në mënyrë të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.”*. Ndërsa, po ashtu nga shkresat e lëndës e rezulton se Komisioni Disiplinor i Agjencisë, nuk ka marrë për bazë pikëpamjet tjera juridike nga Vendimi A.nr.1259/2025 të datës 03.09.2025, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, përmes të cilit ndër të tjerat pikëpamje që u theksuan më lartë, Komisioni duke marrë për bazë pretendimet ankimore të ankuesit se hardisku i vjetër është lënë në zyrë, me qëllim të vendosjes në mënyrë të drejtë për rastin përkatës, është dashur të ftoj për deklarime edhe kolegët e zyrës- Divizionit të TI-së, lidhur me deklaratimet e tyre rreth hardiskut, e që faktikisht nga shkresat e lëndës nuk vërehet të jetë tentuar të ndërmarret ndonjë veprim sipas kësaj pikëpamjeje të organit epror, e për më tepër kjo çështje nuk është trajtuar fare në aktin kontestues me ankesë.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, me rastin e dërgimit të kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 19.01.2026, tek Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, ndër të tjera ka kërkuar dëshmi se a është ekzekutuar Vendimi i Komisionit Disiplinor, sipas Vendimit me Ref.nr.02328/25 të datës 23.12.2025, ndërsa, nga përgjigja në ankesë e datës 04.02.2026, organi i punësimit ndër të tjera lidhur me këtë pikë ka theksuar se citoj: *“ju informojmë se duke u bazuar në faktin se agjencia është në fazën e ristrukturimit dhe me qëllim që nëpunësit ti gjendet vendi i punës në pajtim me të gjitha kualifikimet dhe përgatitjet shkollore, deri në momentin e kthimit të përgjigjes, nuk është nxjerrë vendim për transferimin e nëpunësit SH.K sipas Vendimit të Komisionit Disiplinor”*, mirëpo, faktikisht ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës, ndër të tjera ka bashkangjitur Vendimin me Ref.nr.02328/25 të datës 23.12.2025, i cili është nxjerrë nga Drejtoresha e Sekretarisë Ekzekutive e Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, për zbatimin e Vendimit me nr. ref.02277/25 të Komisionit Disiplinor, gjegjësisht ekzekutimit të masës disiplinore *transferim në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë*, ku ankuesin përsëri e ka caktuar në pozitën e punës “Zyrtar Regjional i Pranimi” në Departamentin për Koordinim Regjional, pranë Zyrës Regjionale në Mitrovicë.

Andaj, mbi bazë të kësaj që u theksua me lartë Kolegji i Këshillit, konstaton se Agjencia përmes kësaj përgjigje në ankesë duke mos ofruar dokumentacionin sipas emalit të datës 19.01.2026, ka tentuar që ta vë në lajthitje Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar që nuk ka vendim për zbatim të vendimit të Komisionit Disiplinor, fakt ky i pa qëndrueshëm për arsye se pala ka ofruar të njëjtin akt, e në kuadër të kësaj vlerësojmë se Agjencia i është shmangur bashkëpunimit korret me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ose ka tentuar të fshehtë faktet dhe argumentet të cilat janë relevante në këtë procedurë administrative.

Ndërlidhur, me çështjen e formatizimit dhe ndërrimit të hardiskut, Kolegji i Këshillit, në Vendimin A.nr.1259/2025 të datës 03.09.2025, duke u bazuar në formularin e përshkrimit të detyrave të punës të ankuesit për pozitën Zyrtar Mbështetës, ku sipas pikës IV. Detyrat Kryesore, rezulton se janë përcaktuar këto: 1. *Ofron mbështetje teknike për harduerin dhe softuerin e kompjuterit në mjedis rrjeti të Agjencisë;* 2. *Identifikon, hulumton dhe zgjidh problemet teknike të sistemit kompjuterik si: korrigjimin, riparimin, servisimin, ekzaminimin, instalimin, trajnimin dhe zgjidhjen e problemeve të pajisjeve kompjuterike, printerëve dhe pajisjeve të tjera periferike;* 3. *Mirëmban rrjetin LAN në objektin qendrorë dhe zyrat regjionale, teston lidhjet dhe sipas nevojës ndërton kablllo të shkurta. Kyç dhe largon nga rrjeti LAN kompjuterët;* 4. *Dokumenton, gjurmon dhe monitoron problemin për të siguruar një zgjidhje në kohë* 5. *Punon vazhdimisht në një detyrë deri në përfundimin (ose referimin tek palët e treta, nëse është e përshtatshme);* 6. *Përgjigjet brenda afateve kohore të dakorduara për thirrjet dhe kërkesat e stafit;* 7. *Kryen edhe detyra tjera profesionale në pajtim me legjislacionin, të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.*; e për rrjedhojë Kolegji i Këshillit, kishte konstatuar se formatizimi i kompjuterëve duke përfshirë edhe ndërrimi i HDD-së (hardiskut) brenda organit përkatës të punësimit, janë disa nga detyrat kryesore të ankuesit, fakt ky që dëshmohet edhe përmes raporteve javore të ankuesit të bashkangjitura me rastin e parashtrimit të ankesës, të cilat rezulton se i njëjti me datë 14.02.2025, 21.03.2025 dhe 28.03.2025, i ka dërguar tek z. N.B. ish-Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji Informative në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Ndër tjera, Kolegji i Këshillit, në Vendimin A.nr.1259/2025 të datës 03.09.2025, ka theksuar se me rastin e parashtrimit të kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 12.07.2025, në mes tjerash ka kërkuar: *Dëshmi se a ka qenë praktikë të lëshohet autorizim për formatizimin në AKKVP (kërkesat dhe autorizimet)*; ndërsa, nga përgjigja në ankesë e Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, Këshilli nuk ka pranuar një dëshmi që argumenton se brenda këtij institucioni është kërkuar autorizim paraprak për formatizimin e kompjuterëve apo ndërrimin HDD-ve, si dhe po ashtu e njëjta dëshmohej edhe nga procesverbali i datës 03.06.2025, i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë paraprak të ankuesit z. N.B, i cili ndërlidhur me pyetjen e Komisioni Disiplinor, se a ekziston ndonjë protokoll apo procedurë e brendshme e shkruar që rregullon punën në Divizionin e IT-së, ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë dokument të brendshëm si Procedurat Standarde Operative (PSO) në Divizionin e IT-së. Ndër të tjera, i njëjti ka deklaruar se me problemet hardverike në përgjithësi është marrë z. K (ankuesi), dhe se po ashtu ka theksuar se kur kanë pasur kërkesa për të formatizuar një kompjuter apo për të ndërruar hardiskun, zakonisht kemi diskutuar me zyrën e TI-së, e kemi verifikuar dhe konstatuar paraprakisht me z. K. (ankuesin), nëse duhet të ndërrohet apo jo, dhe se i njëjti ka qenë në dijeni të plotë gjdo herë për këto veprime, duke shtuar më tej se SH. (ankuesi) ka bërë vlerësimin. Ndërsa, në e-mailin e datës 13.06.2025, z. N.K, ka deklaruar se sa i përket ndërrimit të hardiskut, nuk ka pasur kërkesa specifike për të realizuar një veprim të tillë, por kur kompjuteri është sjellë për servis, pas konstatimit nga zyrtari i IT-së z. K. (ankuesi), është vlerësuar se ndërrimi i hardiskut është i domosdoshëm për të përmirësuar funksionimin e kompjuterit, dhe se këto punë teknike janë realizuar kryesisht nga z. K. (ankuesi), duke shtuar se megjithatë se si divizion i TI-së, i përbërë prej tre anëtarësh, kemi diskutuar bashkërisht rreth problemeve të paraqitura.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se gjendja faktike dhe rrethanat në rastin përkatës lidhur me kërkesën dhe autorizimin për formatizimin dhe ndërrimin e HDD-së, nuk janë të njëjta sikurse me rastet e deklarimeve të më sipërme nga z. N.K, ngase siç u theksua edhe më sipër është vetë detyrë ankuesit formatizimi dhe ndërrimi i HDD-vë, dhe se përkitazi me këto lloj veprimesh Kolegji i Këshillit nga shkresat e disponueshme të lëndës nuk ka gjetur dëshmi apo argumente, që provojnë se njëri nga zyrtarët e TI-së brenda organit përkatës të punësimit, ka paraqitur ndonjëherë kërkesë tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo zyrtari kryesor administrativ për ndërmarrjen e këtyre veprimeve lidhur me pajisjen e tij kompjuterike, madje sipas procesverbalit të datës 02.12.2025, iniciuesi i procedurës disiplinore, në pyetjen e parashtruar nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor z. D., se a i keni njoftuar zyrtarët e zyrës që nuk duhet me punuar diçka pa dijeninë tënde, iniciuesi z. Osmani, ka deklaruar se jo nuk i kam njoftuar por ata duhet me dit që për gjithçka Udhëheqësi duhet me qenë në dijeni, nga rezulton se edhe vet iniciuesi deklaroi se nuk i ka njoftuar vartësitë e tij lidhur me ndërmarrjen e veprimeve për kryerjen e detyrave të punës apo ndërmarrjen e veprimeve sikurse të rastit përkatës.

Me qëllim të vendosje meritore në kuptim të zbatimit efikas të parimit të menaxhimit të zyrtarëve publik të përcaktuar si në neni 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, s ë vijim: “1. *Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunës/it civil, nëpunës/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunës/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mos diskriminimit.*”, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e aplikuara në frymën e zbatimit të drejtë të nenit 2 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërlidhur me parimin e ligjshmërisë, parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë dhe mos

diskriminimit dhe parimin e pritshmërisë së ligjshme, të përcaktuara si në nenin 4 paragrafi 1, nenin 5 paragrafi 1, nenin 6 paragrafi 1, 2 dhe 3, si dhe nenin 8 paragrafi 1, nga i njëjti ligj, sikurse përcaktohet: **“Neni 4 Parimi i ligjshmërisë 1.** Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca; **Neni 5 Parimi i proporcionalitetit 1.** Një veprim administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit; **Neni 6 Parimi i barazisë dhe mos diskriminimit 1.** Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mos diskriminimit. 2. Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse. 3. Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit; **Neni 8 Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme 1.** Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave.”, si dhe duke marrë për bazë konstatimin dhe pikëpamjet juridike si në Vendimin e Këshillit A.nr.1259/2025 të datës 03.09.2025, Kolegji i Këshillit, nuk ka mundur të përligj shkeljet e përcaktuara si më lartë nga ana e organit të punësimit fillimisht, për arsye të ekzekutimeve të masave disiplinore, edhe pse faktikisht kjo masë dhe vendimi për ekzekutimin e kësaj mase janë shfuqizuar sipas këtij akti të organit eprorë, mirëpo që pavarësisht kësaj organi i punësimit ka vazhduar edhe më tej ekzekutimin e kësaj mase disiplinore, duke krijuar me këtë rast rrethana të paqarta lidhur materialin shpenzues dhe jo shpenzues që ankuesi ka lënë në vendin e tij të punës, përkatësisht nuk ka aplikuar procesverbal mbi të cilën mund të konstatohej se çfarë ka lënë ankuesi në vendin e tij të punës, e më tej edhe të Komisionit Disiplinor, ngase i njëjti nuk ka marrë për bazë pikëpamjet dhe obligimet e dala nga vendimi i Këshillit, kishte parasysh kthimin e lëndës në rishqyrtim, mirëpo nga situata e krijuar si pasojë e ekzekutimit të vendimit të komisionit disiplinor dhe tentimit të organit të punësimit për fshehje apo mos ofrim të provave relevante për zgjidhjen meritorisht të çështjes përkatëse, duke pamundësuar kështu konstatimin e drejtë të konsumimit apo jo të përgjegjësiave disiplinore nga ankuesi, dhe mbi këtë bazë ndërlidhur edhe me parimet e përcaktuara si në nenin 4, 5, 6 dhe 8 të LPPA-së, Kolegji i Këshillit, vendosi të aprovoi ankesën e ankuesit si të bazuar, ngase nuk mundte të përligjte për herë të dytë të njëjtat veprime të organit të punësimit dhe ta kthente sërish çështjen në rishqyrtim tek organi i njëjtë për arsyet e sapo theksuara, thënë më konkretisht për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve rast pas rasti të theksuara në këtë procedurë disiplinore, Kolegji i Këshillit, nuk mund ti falë besimin Komisionit Disiplinor dhe as vet këtij organi punësimi lidhur me këtë çështje disiplinore.

Andaj, bazuar në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit mbështetur në dispozitat e aplikuara sikurse përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr.05/-L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: **“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit.”**, vendosi që të aprovoi ankesën e ankuesit, ndërsa të anuloi Vendimin Nr.Ref.02277/25 të datës 17.12.2025, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikimi të Pronës, si dhe Vendimin Ref.nr.02328/25 të datës 23.12.2025, të Drejtoreshës së Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, me obligimin ligjor që kjo e fundit të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike me qëllim të kthimit të ankuesit në vendin e tij të punës

sipas Akt emërimit me Nr.00113/2025 të datës 06.01.2025, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.15/2026

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit SH.K;
- Drejtoreshës së Sekretarisë Ekzekutive dhe Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.